

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A**Data: 12.01.2026****PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra****PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale elektrike, hidraulike, pompa uji, aksesori për dyer dhe dritare, mbushje fikse zjarri” për Spitalin Rajonal Durrës, për periudhën 12 muajore.

Loti:
Lot 1 “Materiale elektrike, hidraulike, aksesori për dyer dhe dritare, aksesori për pompat, aksesori lyerje”
Lot 2 “Mbushje fikse zjarri”

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë E Hapur e Thjeshtuar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me disa operator ekonomikë (me një fitues për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):**Materiale elektrike 31681410-0****Materiale hidraulike 44115210-4****Pompa uji 42122130-0****Fikse zjarri 44482100-3**

FONDI LIMIT: 2,666,324 (dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH

- **Loti 1 “Materiale elektrike, hidraulike, aksesori për dyer dhe dritare, aksesori për pompat, aksesori lyerje”, me fond limit: 2,484,824 (dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH.**
- **Loti 2 “Mbushje fikse zjarri” me fond limit 181,500 (njëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

PËR LOTIN 1 “MATERIALE ELEKTRIKE, HIDRAULIKE, AKSESOR PËR DYER DHE DRITARE, AKSESOR PËR POMPAT, AKSESOR LYERJE!

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkojnë operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit është nën vlerën e kufirit të ulët monetar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e fondit limit** të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4/c të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1 (një)** automjet për transportin e mallrave objekt prokurimi, të cilin duhet ta ketë në pronësi, me qira ose në përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë si :

- a. Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
- b. Leje qarkullimi,
- c. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm),
- d. Sigurimin e detyrueshëm të mjetit (e vlefshëm).
- e. Fotografi të mjetit ku të evidentohet targa.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesit e kualifikuar si të sukseshëm, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë. Kërkesa për 1 (një) mjet është vendosur në propocion me sasinë e mallit që kërkohet dhe vendodhjen e objektit të Autoritetit Kontraktor përfitues, ku do të depozitohet malli objekt prokurimi.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi, do të jenë të papërdorura më parë (të reja) dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **katalog/skedë teknike** për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit. Nëse katalogu/ët /skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues, me anë të kësaj skede teknike, të garantojnë Autoritetin Kontraktor se artikujt e ofruar do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me

atë të deklaruar në ofertë dhe që përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike të artikujve objekt prokurimi.

5. Për artikujt me numer rendor 1,11,20 “Materialet Elektrike”,96, 108 “Aksesor për dyer dhe dritare”, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130 “Aksesor për pompa uji” në tabelen e formularit të specifikimeve teknike (shtojca 6) në DST objekt prokurimi Loti 1, ofertuesi duhet të paraqesë mostra në ditën e hapjes/dorëzimit të ofertave. Dorëzimi i mostrave, të bëhet prane Operatorit të Blerjeve të Përndruara, me adrese ”Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)”, te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

*“Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit: **Loti 1 “Blerje materiale elektrike, hidraulike, pompa uji, aksesor për dyer dhe dritare”, dhe jo para datës ____./2026, ora 11:00 (*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave).***

Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkresë te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.

Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr. Rendor te Artikullit qe përfaqëson sipas formularit te çmimit.

Ne paketimin e çdo mostre duhet te evidentohet qarte origjina e mallit, e cila duhet te përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe te identifikuara sipas Nr. Rendor te formularit te çmimit, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçante ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbështetje te relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor përfitues, sipas të cilit çmohet e nevojshme paraqitja e mostrave për disa artikuj, për të cilët paraqitja e katalogëve / skedave teknike potencialisht mund të mos ofrojë një panoramë të plotë mbi karakteristikat teknike të produktit. Ky kriter gjen mbështetje ne piken 6 te nenit 40 te të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet,

mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit. Ky kriter gjithashtu gjen mbështetje në Udhëzimin e APP nr. 3, datë 12.04.2022 'Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE'. Paraqitja e mostrave për artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmerisë në vend të materialeve objekt prokurimi që operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike të percaktuara në DST në Shtojcën 6, dhe duke qenë se ato kanë një natyrë të vecante, për të bërë të mundur vlerësimin e tyre është i nevojshëm vlerësimi i tyre përmes mostrës së paraqitur. Sa më sipër, duke u bazuar në natyrën specifike të artikujve objekt prokurimi, kjo kërkesë gjendet në proporcion me objektin e prokurimit dhe e bazuar në ligj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

PËR LOTI 2 “MBUSHJE FIKSE ZJARRI”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, neni 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkojnë operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit është nën vlerën e kufirit të ulët monetar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e fondit limit** të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- c) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4/c të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- **ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë”** (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë liçense nga Qendra Kombëtare e Liçensimit për ushtrimin e aktivitetit të kategorisë "Shërbim ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile" me kategorinë/kodin 1.2.A

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e liçensës së mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40, pika 5 germa (a) dhe pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nenligjore të perbashketa” të ndryshuar.. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencën perkatese lidhur me veprimtarinë për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Objekti i kësaj procedure prokurimi lidhet me ofrimin e shërbimeve të ekspertizës profesionale në fushën e mbrojtjes civile dhe sigurisë nga zjarri, veprimtari e cila, sipas legjislacionit në fuqi, kërkon pajisjen e operatorëve ekonomikë me liçencën përkatëse të kategorisë “Shërbim ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile”, kodi 1.2.A, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Vendosija e këtij kriteri synon të garantojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të autorizuar ligjërisht dhe të kualifikuar për realizimin e shërbimit, në përputhje me standardet teknike, profesionale dhe ligjore në fuqi, duke siguruar cilësinë, sigurinë dhe përmbushjen korrekte të kontratës. Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës, i arsyeshëm dhe nuk cenon parimin e konkurrencës, pasi aplikohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë që ushtrojnë këtë veprimtari.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë një staf të përbërë nga:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për rimbushjen e pajisjeve zjarrfikëse e vërtetuar kjo me paraqitjen e certifikatës së trajnimit.
- 1(një) punonjës të pajisur me certifikate për ushtrimin e profesionit “Ekspert Zjarrfikës” lëshuar nga PMNZSH, Ministria e Brendshme

-të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

Shënim: Një punonjës mund të disponojë të dy kualifikimet e sipërpërmendura.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e

nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Në kuadër të kësaj dispozite ligjore AK ka kërkuar në ftesën për ofertë certifikatat e nevojshme, stafin e duhur dhe ekspertët e duhur për realizimin me sukses të shërbimit të rimbushjes së fiksëve të zjarrit i cili është një proces i cili kërkon staf të përgatitur edhe të trajnuar për realizimin e të gjithë zërave pjesë e preventivit të cilët duhet të zotërojnë profesionalizëm, eksperiencën e duhur dhe përgjegjshmëri për të konkluduar në përmbushjen me sukses të këtij shërbimi i cili është jetik, tepër i rëndësishëm edhe shumë sensitiv.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit me objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues konform specifikimeve teknike.

Argumentimi. *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendndodhjen përkatëse të caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

*Specifikimet teknike dhe argumentimi i tyre janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, **me urdhrin, datë 17.11.2025 (nr. 300/23 prot.)**, me lëndë: “Relacioni i Grupit për përllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale elektrike, hidraulike, pompa uji, aksesori për dritare dhe dritare, mbushje fikse zjarri” për Spitalin Rajonal Durrës për një periudhë 12 muaj, në të cilin janë përcaktuar në mënyrë të detajuar nevojat, specifikimet teknike dhe argumentimi i tyre, si dhe mënyra e përllogaritjes së fondit limit për këtë procedurë prokurimi.*

Lot 1 “Materiale elektrike, hidraulike, aksesori për dritare dhe dritare, aksesori për pompat, aksesori lyerje”

Nr.	Materiale Elektrike
1	Panel led 45- 60 wat tavan I varur 60x60 cm ndricimi 4000 K (20,000 ore pune)
2	Panel led 45- 60 wat tavan jo I varur 60x60 cm ndricimi 4000 K (20,000 ore pune)
3	NEON TUB LED 120 CM 1600 LUMEN (20,000 ore pune)
4	NEON TUB LED 60 CM 850 LUMEN 6400K (20,000 ore pune)
5	NEON TUB LED 150 CM 6400K (20,000 ore pune)

6	Llampe ndricimi LED 8.5 - 10 wat E 27 e bardhe
7	Klema 10
9	Prize shuko universale e bardhe 16 wat (Gewis ose ekuivalent) me CE
10	Zgjatues me shume priza 3 - 5 ml , 3-5 vende kabull 3x2.5mm
11	Panel Led rrethor 30cm tavan I varur
12	Panel Led rrethor 30cm tavan jo i varur
13	Kabull monofaze CU 3x1.5 mm ²
14	Kabull monofaze CU 3x2.5 mm ²
15	Salvavida 220v 32A
16	Rezistenc dushi 100L 2000W
17	Izolant elektrik (Nastro 3 colore)me CE
18	Celes universal 16W per ndicim
19	Portollambe plastike
20	Automat 16C (dy polar)
Nr.	Materiale hidraulike

21	Mekanizëm kasete me dalje fundore (cilesore)
22	Mekanizëm kasete me dalje anesore (cilesore)
23	Filter mishelatori (cilesore material bronx)
24	Fresibel 40 cm F -F (cilesore material bronx)
25	Fresibel 50 cm F -F (cilesore material bronx)
26	Fresibel 60 cm F -F (cilesore material bronx)
27	Fresibel 70 cm $\frac{1}{2}$ x $\frac{3}{8}$ F – F (cilesore material bronx)
28	Reduksion $\frac{1}{2}$ x $\frac{3}{8}$ (cilesore, material bronx)
29	Tape xingato $\frac{1}{2}$ (cilesore)
30	Galixhand 2" (polç) (cilesore)
31	Galixhand 1" (polç) (cilesore)
32	Tube 30mm me ngjitje me gjatesi 3-4m
33	Bryla 25mm l thjeshte
34	Bryla 20mm l thjeshte

35	Bryla 32mm l thjeshte
36	Bryla 32mm me fileto ne koke
37	Bryla 20mm me fileto ne koke
38	Bryla 25mm me fileto ne koke
39	Manikota te thjeshta (bashkuese)20mm
40	Manikota te thjeshta (bashkuese)25mm
41	Manikota te thjeshta (bashkuese)32mm
42	Manikota te me fileto (bashkuese)20mm
43	Manikota te me fileto (bashkuese)25mm
44	Manikota te me fileto (bashkuese)32mm
45	Lubrifikant per tubat me gomina
46	Shirit metalik dhe gozhde per suporte tubi (10m)
47	Niples T 2" me fileto xingato
48	Kundravalvul 2"

49	Kundra valvul 1 1/2"
50	Kundra valvul 1 1/4"
51	Kundra valvul 1"
52	Tube 20mm me ngjitje me gjatesi 3-4m
53	Wc me dalje fundore + kaseta (porcelan)
54	Gomine WC esentrike+tub me gomine 110 te bardhe
55	Tube 110 me gomine per vendosje wc (tub teknik 30 cm)
56	Gomine WC e drejte
57	Gomine lavaman+bide 40 x 32 cm
58	Gomine lavaman+bide 50 x 32 cm
59	Vida WC
60	Fresibel grupi lavamani 50cm
61	Fresibel grupi lavamani 70cm
62	Fresibel grupi lavamani 40cm
63	Boliere 10 liter

64	Silikon (cilesor me afat skadence me te larget se 2026)
65	Teflon I madh
66	Kasete plastike
67	Galixhant me dalje anesore 3/8 " per kasete porcelani (cilesore)
68	Galixhant me dalje fundore 1/2 " per kasete porcelani (cilesore)
69	Saracineske 1"
70	Saracineske 3/4 "
71	Saracineske 1/2 "
72	Saracineske 1 1/2"
73	Saracineske 2"
74	Saracineske 1 1/4"
75	Grup bideje
76	Grup lavamani
77	Kuti paste hidraulike
78	Sita grupi

79	mini saracineska 1/2 me hollandezwe F-M
80	Bashkuese per zore e zeze 1 1/2"
81	Bombul Gazi
82	Shkume per izolime
83	Vida 2.5cm (kuti 100Cope)
84	Tapa 1/2"
85	Tapa 1"
86	Tapa 3/4"
87	Galixhan 2"
88	Galixhan 1/2"
89	Galixhan 3/4"
90	Galixhan 1"
91	Zore e zeze 1 1/2"
92	Celes anglez 0-45mm
93	Ngjitese per tubot 800W 20-63mm
94	Matrapik 1300 W 10 J

95	Sifon me pilete
Nr.	Aksesore per dyer dhe dritare
96	Brave per dere druri me fishek 17.5 cm x 7 cm (me certifikim CE)
97	Brave per dere duralumini me fishek 17.3 cm x 4.5 cm
98	Brave per dere duralumini me fishek 17.3 cm x 4.3 cm
99	Fisheke per dere durali
100	Fisheke per dere druri 6.5cm
101	Doreze per dere druri
102	Doreza per dere metalike
103	Doreze plastike dritareje durali
104	Doreze durali dritareje durali
105	Doreze durali 14 cm dritareje durali
106	Doreze superluceje durali + kapakun cift
107	Menteshe dritareje durali 9 cm me diameter 1.3cm

108	Mentesha Dyersh(cift)
109	Vida punto 2cm dhe 3 cm ,4cm
110	Shul
111	Komplet kacavidash
112	Troko fresibel me bateri
113	Vidator me bateri
114	Elmaz per prerje xhamash (si thike me diamant ne koke)
115	Disk fresibel per dru per troko te vogel
116	Shar dore profesionale per dru
117	Disk fresibel per hekur per troko te vogel
118	Brave druri me rrula me dimensione 17x6.5
119	Dopio xham per dritaret
120	Kartoser (katerma per izolime)2.5mm
121	Shul per dritare durali
Nr.	Aksesor per pompat

122	Pompe zhytесе 3" 2200W h=13m прurja 600 l/m
123	Pompe 3.5W 380V (3 fazorshe) me hyrje dalje 1 1/2 "
124	Pompe 5.5W 380V (3 fazorshe) me hyrje dalje 1 1/2 "
125	F.V. Panel elektrik komandimi automatik te kompletuar (per dy pompa 11.5kW)
126	F.V.Gomerdare per Balon presioni 500 liter.
127	F.V. Balon presioni 300 liter.
128	F.V. Balon presioni 500 liter.
129	Kolektor per pompat 2"
130	Tub fresibel 2 polc 50 cm M -F.
Nr.	Aksesore Lyerje
131	Kole per pllakat me thase DW2000 (25kg)
132	Dorashka
133	Boje per lyerje hekuri ,alumini
134	Astar boje plastiko

135	Boje plastike
136	Boje hidromat
137	Mbajtese boje
138	Furca boje
139	Rrula per te lyer per bojra hidroat e plastike bashke me suport
140	Rrula per te lyer per bojra hekuri ,alumini e plastike bashke me suport
141	Rrula per bojra muri
142	Rrula per bojra metali
143	Shpatull e madhe per stukime
144	Shpatull e vogel per stukime
145	Ngjites letre per mure
146	Stuko per stukime muri me thase 25kg
147	Hollues Boje

Për pjesët elektrike veçojmë panelet elektrike, të cilat janë me përmasa 60 cm dhe 30 cm. Këto përmasa janë të domosdoshme pasi suportet ekzistuese janë të këtij tipi dhe nuk pranojnë përmasa të tjera. E njëjta logjikë vlen dhe për kabujt, të cilët kanë specifikimet e trashësisë sipas pajisjeve ku do të përdoren dhe fuqisë që kërkohet. Gjithashtu, edhe pjesa e neonëve ka suportet përkatës sipas specifikimeve të gjatësisë. Për pjesen e automatikëve, salvavitave dhe çelësave, këto janë përcaktuar sipas fuqisë së nevojshme pasi duhet të mbajnë ngarkesën përkatëse.

Për materialet elektrike veçojmë tubot fleksibël, manikotat, tapot, saricinat dhe bashkueset, të cilat janë studiuar sipas nevojave të SRD-së dhe janë kërkuar në përputhje me pajisjet e nevojshme dhe vendet ku do të instalohen, sipas specifikimeve përkatëse. Sa i përket matrapikut 1300 W/ 10 J, ai është i përshtatshëm për fuqinë që ka dhe për vendet ku do të përdorët. Pajisja ngjitëse për tuba 800 W (20-63 mm) ka dhe për vendet ku do të përdorët. Pajisja ngjitëse për tuba 800 W (20-63 mm) është kërkuar me këto specifika pasi të gjithë tubat në SRD janë të këtyre përmasave.

Për aksesoret e dyerve dhe dritareve, llojet dhe përmasat janë matur dhe përcaktuar në përputhje me dyert dhe dritaret ekzistuese të SRD-së, duke u bazuar edhe në eksperiencën shumëvjeçare të përdorimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Për aksesoret për pompa, janë specifikuar bazuar në materialet ekzistuese, të cilat janë të dëmtuara ose jashtë përdorimit, dhe kërkojnë zëvendësim me elementë të së njëjtës kategori për shkak të përshtatshmërisë me vendin ku instalohen. Pompat zhytëse duhet të jenë me parametrat përkatës, të studiuar sipas lartësisë, fuqisë, prurjes dhe vendndodhjes së instalimit. Gjithashtu, panelet elektrike duhet të përputhen me këto specifika pasi pompat kërkojnë këtë tipologji. E njëjta logjikë zbatohet edhe për ballonin e presionit.

Për aksesoret e lyerjes, janë përcaktuar sipas materialeve që i përshaten punimeve përkatëse. Veglat e punës, si furçat, rrotullat dhe shpatullat, janë zgjedhur në raport me llojin e bojës së kërkuar. Boja është specifikuar sipas nevojave dhe tipologjisë së mureve.

Loti 2 “Mbushje fikse zjarri”

Nr.	Emertimi	Njesia
1	Mbushje dhe kolaudim bombule me pluhur kunder zjarri 9 kg	cope

Për mbushjen dhe kalibrimi i bombulave me pluhur kundër zjarrit 9 kg kërkohet në këto kapacitete, pasi bombulat tona ekzistuese kanë specifikë 9 kg dhe funksionojnë me mbushje pluhuri.

NJËSIA E PROKURIMIT